



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Njoftim Specifik i Prokurimit – Kërkesë për Propozime pa Parakualifikim

Kërkesë për Propozim Sistemet e Informacionit (Dizajnimi, Furnizimi dhe Instalimi) (Pa Parakualifikim)

Blerësi: Agjencia Kadastrale e Kosovës

Projekti: *Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP)*

Titulli i kontratës: *ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I SISTEMEVE TË INFORMACIONIT KADASTRAL*

Shteti: *Republika e Kosovës*

Nr. i Huasë / Nr. Kredisë / Nr. i Grantit: *IDA-63540*

Nr. RFP: *XK-KCA-385082-NC-RFP*

Publikuar më: *7 dhjetor 2023*

1. Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë financim nga Banka Botërore për koston e Projektit të Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), dhe synon të shfrytëzojë një pjesë të të ardhurave për pagesat sipas kontratës¹ për

¹ “Kontratë” zëvendësuese ku njëkohësisht bëhet thirrje për Propozime për kontrata të shumta. Të shtohet paragrafi i ri 3 dhe të rinumërohen paragrafët 3 - 8 si më poshtë: “Propozuesit mund të bëjnë propozime për

ZHVILLIMIN DHE AVANCIMIN E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT KADASTRAL.

2. Agjencia Kadastrale e Kosovës bën thirrje për oferta të vulosura nga ofertuesit e kualifikuar për ZHVILLIMIN DHE AVANCIMIN E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT KADASTRAL.

Objektivat themelore të këtij aktiviteti janë si në vijim:

Përmirësimi i funksionalitetit të sistemeve ekzistuese: Fokusi është të bëhen ndryshime në sistemet e informacionit për administrimin e tokës, për të rritur performancën dhe menaxhimin e cilësisë së të dhënave për të gjitha sistemet. Disa nga sistemet e informacionit përdorin teknologji të vjetër dhe duhet të përmirësohen me teknologjinë më të re, në mënyrë që të kenë funksionalitete të reja dhe performancë më të mirë. Një tjetër përmirësim i sistemeve është ndryshimi i rrjedhës së punës për ta bërë më të lehtë dhe më fleksibil përdorimin e tyre.

Përmirësimi i interoperabilitetit të sistemit, veçanërisht me sistemet e jashtme: Nga komunikimet aktuale me sisteme të jashtme, kemi vërejtur se cilësia e të dhënave është rritur dhe procesimi i të dhënave është shumë i shpejtë. Kjo ka ndihmuar përdoruesit fundorë të kenë të dhënat nga sistemet e jashtme të validuara plotësisht dhe të përditësuara. Jemi të përqendruar në rritjen e numrit të institucioneve publike dhe private për të komunikuar me to në kohë reale, pasi që shkëmbimi i të dhënave do të jetë me cilësi të lartë dhe të gjitha palët e interesit do të marrin të dhënat në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.

Ridizajnimi i modelit të të dhënave, në përputhje me standardin ISO 19152 LADM: Disa nga bazat aktuale të të dhënave janë në përputhje me standardin LADM, por ende kanë nevojë për disa përmirësime dhe avancime për të përmbushur më mirë standardin LADM. Do t'i analizojmë këto baza aktuale të të dhënave dhe do të vendosim se çfarë mund të përmirësohet, por pa bërë ndryshime rrënjësore, pasi kemi të dhëna të ruajtura në ato baza të të dhënave dhe duhet të jemi shumë të saktë në konvertimin dhe migrimin e tyre pa humbur asnjë informacion.

3. Procesi i prokurimit do të kryhet përmes prokurimit konkurrues ndërkombëtar duke përdorur Kërkesën për Propozime (KP) siç specifikohet në “Rregulloret e Prokurimit për Huamarrësit e FPI-së” të Bankës Botërore, dhe është e hapur për të gjithë Propozuesit e kualifikuar siç përcaktohet në Rregulloret e Prokurimit.
4. Propozuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin informata shtesë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, *Specialist i Prokurimit*, emaili për REGIP: prokurimi.regip@rks-gov.net dhe të kontrollojnë dokumentin e kërkesës për propozime gjatë orarit të punës nga ora 09:00 deri në orën 16:00 (koha lokale) në adresën e dhënë më poshtë:
Adresa: Rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, Objekti i Arkivit, kati 2,
10 000, Republika e Kosovës
5. Dokumenti i kërkesa për propozimeve në gjuhën angleze mund të merret falas nga ofruesit e interesuar dhe të kualifikuar.

një ose disa kontrata, siç përcaktohet më tej në dokumentin e kërkesës për propozime. Propozuesit që dëshirojnë të ofrojnë zbritje në rast se u jepen më shumë se një kontratë do të lejohen ta bëjnë këtë, me kusht që këto zbritje të përfshihen në Letër Propozimi.”

Kompleti i plotë i dokumenteve të Kërkesës për Propozim (KP), duke përfshirë çdo sqarim, njoftim dhe/ose shtesa, mund të merret nga Propozuesit e interesuar dhe të kualifikuar. Për të pasur qasje në dokumente, ofruesit e interesuar mund të kenë qasje në dokumentet e KP-së duke përdorur linkun e mëposhtëm: <https://akk.rks-gov.net/en/shpallje>

Propozuesit e interesuar për të paraqitur propozim duhet të regjistrojnë interesin e tyre duke dërguar një regjistrim të plotësuar te Specialisti i Prokurimit, REGIP në emailin: prokurimi.regip@rks-gov.net. Subjekti i emailit duhet të jetë “ZHVILLIMI DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT KADASTRAL_Emri i kompanisë”. Një kopje e emailit duhet gjithashtu të dërgohet te Muzafër.Qaka@rks-gov.net. Në email, propozuesit duhet të japin detajet e tyre të plota të kontaktit. Regjistrimi në këtë mënyrë siguron që Propozuesit do të përditësohen në lidhje me KP-në.

6. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme më ose para **22 janarit 2024, ora 14:00**. Prokurimi elektronik **nuk do të** lejohet. Propozimet pas afatit do të refuzohen. Në pjesën e jashtme të zarfi, Propozimi duhet të përmbajë shënimin “PROPOZIMI ORIGJINAL” ndërsa zarfet e brendshëm shënimin “PJESA TEKNIKE” që do të hapen publikisht në prani të përfaqësuesve të caktuar të Propozuesve dhe kujtdo që zgjedh të marrë pjesë, në adresën e mëposhtme më **22 janar 2024, në orën: 14:15**. Të gjitha zarfet me shënimin “PJESA FINANCIARE” do të mbeten të pahapura dhe do të mbahen të sigurta nga Blerësi deri në hapjen e dytë të Propozimeve publike.
7. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me një **Deklaratë për Sigurimin e Propozimit**.
8. Vëmendje duhet t’i kushtohet Rregulloreve të Prokurimit që kërkojnë që Huamarrësi të shpallë informacion mbi pronësinë përfituese të Propozuesit të suksesshëm, si pjesë e Njoftimit për Dhënie të Kontratës, duke përdorur Formularin e Shpalljes të Pronësisë Përfituese siç përfshihet në dokumentin e kërkesës për propozim.
9. Adresa e përmendur më sipër është:

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Për vëmendje të: Specialisti i Prokurimit, REGIP.

Adresa: rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, Objekti i Arkivit, kati 2,
10 000, Republika e Kosovës

Email:

Për: prokurimi.regip@rks-gov.net

Cc: Muzafër.Qaka@rks-gov.net